


## 2017 QËNDRUESHMËRIA E OSHC-VE: 3.7



Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në BE që prej vitit 2014. Hapja e negociatave të anëtarësimit varet nga arritja e mëtijshme e rezultateve të prekshme në pesë prioritetet kyçe: reforma e gjyqësorit, reforma e administratës publike, lufta kundër krimit të organizuar, lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Zbatimi në vazhdim i reformës së gjyqësorit është veçanërisht vendimtar për avancimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë. Vendi miratoi një paketë gjithëpërfshirëse të reformës në drejtësi në korrik të vitit 2016. Gjatë vitit 2017, hapat e para të zbatimit ishin të ngadalta dhe të shoqëruara me përplasje politike.

Zgjedhjet e përgjithshme ishin planifikuar të mbaheshin në qershor, por në shkurt opozita shprehu qëllimin e saj për bojkot duke ngritur një çadër proteste në kërkim të zgjedhjeve të lira dhe një qeverie teknike. Në maj u arrit një marrëveshje për të zhvilluar zgjedhjet, pasi krerët e Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD) arritën një marrëveshje politike, që përfshinte një riorganizim të kabinetit qeveritar. Në 25 qershor, partia në pushtet (PS) fitoi një shumicë parlamentare e vetme.

Përkundrejt këtij konteksti, qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit pati një përmirësim të lehtë gjatë vitit 2017, me zhvillime pozitive të vërejtura në dimensionet e ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së sektorit. OShC-të vijuan përpjekjet për të rritur bazën e tyre mbështetëse dhe për t'u angazhuar në ndërtimin e koalicioneve. Qëndrueshmëria financiare vazhdon të mbetet dimensionin më i dobët i sektorit. OshC-të ende nuk kanë zhvilluar një bazë të diversifikuar financimi dhe nuk kanë kapacitete të mjaftueshme organizative për të zgjeruar burimet e tyre financiare.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë janë regjistruar mbi 10,000 OShC - duke përfshirë shoqata, fondacione dhe qendra. Megjithatë, numri i përgjithshëm i OShC-ve aktive të regjistruara pranë organeve tatimore është vetëm 3,922. Gjatë vitit 2017, në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë u regjistruan 339 OShC të reja, nga të cilat 283 u regjistruan edhe tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

## MJEDISI LIGJOR: 3.7



MJEDISI LIGJOR NË SHQIPËRI

Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, i cili është dokumenti strategjik që orienton politikën e qeverisë ndaj sektorit. Në fund të vitit, u lançua një mjet konsultimi elektronik dhe u organizuan katër runde takimesh për të mbledhur propozimet e OShC-ve mbi kornizën e zbatimit dhe monitorimit të Udhërrëfyesit. Zbatimi i Udhërrëfyesit që prej 2015 ka pasur ritëm të ngadaltë.

Përkundër kërkesave nga OShC-të dhe faktit se është identifikuar si një masë prioritare legjislative në Udhërrëfyes, gjatë vitit nuk u ndërmarran veprime për decentralizimin e procesit të regjistrimit. Si pasojë, OShC-të vazhdojnë të regjistrohen në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë. Regjistrimi mbetet burokratik, i gjatë dhe i kushtueshëm, sidomos për OShC-të vendore me vendndodhje jashtë kryeqytetit. Procedurat për ndryshimin e statuteve si dhe ato për shpërndarjen dhe likuidimin mbeten gjithashtu të mundimshme.

Gjatë vitit 2017, mbeti akoma pezull zbatimi i ligjeve mbi Vullnetarizmin dhe Ndërmarrjet Sociale, të cilat hynë në fuqi në vitin 2016 dhe janë fusha prioritare të Udhërrëfyesit. Zbatimi i të dy ligjeve varet nga miratimi i legjislacionit dytësor - për shembull, për të specifikuar procedurat për dhënien e statusit të ndërmarrjeve sociale, listën e veprimtarive konkrete që ushtrojnë dhe rregullimi i formës së mbështetjes shtetërore - të cilat Këshilli i Ministrave nuk arriti t'i miratonte gjatë vitit.

Burimet jo-fitimprurëse të të ardhurave për OShC-të, duke përfshirë pagesat e përfituara nga kuotizacionet, fondet, grantet dhe donacionet përjashtohen nga TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat. OShC-të që zbatojnë projektet e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) të BE kanë të drejtë të kërkojnë rimbursimin e TVSH-së për shpenzimet e tyre, por për shkak të paqartësive ligjore dhe procedurave burokratike, asnjë OShC nuk raportohet të ketë kërkuar rimbursim deri më sot. Kompanitë private përfitojnë lehtësi minimale tatimore për donacionet e tyre deri në 5 përqind të fitimit mbi tatimin. Individët nuk përfitojnë asnjë lehtësi tatimore për donacionet e bëra për OShC-të. OShC-të i kanë kërkuar prej kohësh vendimmarrësve miratimin e një ligji të ri për filantropinë, i cili bën dallimin midis aktivitetit filantropik dhe sponsorizimit.

Që nga viti 2015, OShC-ve aktive u kërkohet dorëzimi elektronik i deklaratave tatimore mujore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Kuadri ligjor i OShC-ve nuk pësoi ndryshime gjatë vitit 2017. Regjistrimi dhe funksionimi i OJF-ve është i përcaktuar qartë në legjislacion dhe OShC-të janë përgjithësisht të lira nga ndërhyrja e qeverisjes qendrore. Megjithatë, mbetet i nevojshëm ndryshimi i legjislacionit për decentralizimin e procesit të regjistrimit, përmirësimin e trajtimit fiskal të OShC-ve, standardizimin e procedurave për shpërndarjen e fondeve publike dhe inkurajimin e filantropisë.

Gjatë muajit dhjetor, nëpërmjet asistencës teknike të BE, Kryeministria filloi konsultimet publike në kuadër të rishikimit afatmesëm të Udhërrëfyesin të vitit 2015 për

OShC-të lejohen ligjërisht të fitojnë të ardhura nga ndjekja e veprimtarive ekonomike ose nëpërmjet kontratave të prokurimit publik. Të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike janë të përjashtuara nga TVSH-ja për OShC-të që veprojnë në fushat sociale, arsimore, kulturore dhe sportive, kur kjo njihet nga autoritetet kombëtare kompetente dhe me kusht që të ardhurat të përdoren për të ndjekur misionin e organizatës.

Hendeku i kapacitetit ligjor vazhdon të ekzistojë midis Tiranës dhe rretheve. Si rezultat, OShC-të jashtë kryeqytetit hasin vështirësi në aksesimin e asistencës ligjore të specializuar *pro bono*. Në dhjetor të vitit 2017 u miratua ligji 111/2017 për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti. Ky ligj, i cili hyn në fuqi në qershor 2018, rregullon organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. Sipas ligjit, OShC-të kanë tani të drejtën të ofrojnë ndihmë juridike parësore.

## KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.7


Kapaciteti organizativ i OShC-ve në Shqipëri ka pësuar ndryshime të pakta gjatë katër viteve të fundit. Vazhdon të ketë një hendek të madh të kapaciteteve ndërmjet OShC-ve në Tiranë dhe atyre jashtë kryeqytetit.

Sipas evidencës ankedotale OShC-të gjatë vitit 2017 kanë shtuar përpjekjet për të identifikuar përfituesit e tyre potencialë dhe për të ndërtuar bazë mbështetëse, kryesisht në përbushje të kërkesave të donatorëve. Pavarësisht kësaj, OShC-të lokale që punojnë ad hoc vazhdojnë të hasin vështirësi dhe të gëzojnë më pak mbështetje nga komuniteti sesa organizatat me bazë në Tiranë dhe me shtrirje kombëtare, kjo kryesisht për shkak të burimeve më të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe niveleve të larta të apatisë në nivel lokal.

Ndërsa OShC-të e konsoliduara priren të kenë vizione dhe misione të përcaktuara qartë, OShC-të në nivel lokal hasin vështirësi në pasjen e misioneve të mirë-përcaktuara duke ndjekur ndërkohë misione të gjera në mënyrë që të jenë candidate për më shumë burime financimi. Vetëm një pjesë e vogël e OShC-ve kanë përcaktuar plane strategjike. Megjithatë, edhe në këto organizata është e paqartë se deri në çfarë mase teknikat e planifikimit strategjik inkorporohen në proceset vendimmarrëse. Mundësitë e pamjaftueshme të financimit institucional i kanë shtuar edhe më tej këto probleme.

Statutet e OShC-ve duhet të përshkruajnë sistemet e tyre të brendshme drejtuese. Sipas ligjit, organi më i lartë vendimmarrës në organizatat pa anëtarësi (fondacione dhe qendra) është bordi i drejtorëve, ndërsa për organizatat me anëtarësim (shoqatat), është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj. Megjithatë, në praktikë, bordet e drejtorëve në përgjithësi nuk arrijnë të angazhohen në qeverisjen organizative dhe e delegojnë autoritetin tek drejtorët ekzekutivë.

Megjithëse nuk ka të dhëna statistikore mbi punësimin në sektor, në përgjithësi vetëm OShC-të e mëdha janë në gjendje të mbajnë personel të paguar të përhershëm. OShC-të lokale kryesisht angazhojnë staf në bazë të projekteve. Gjithashtu, të punësuarit në OShC vazhdojnë të kenë përgjegjësi të shumëfishta. Ligji për Vullnetarizmin u miratua në vitin 2016, por ndikimi i tij mbetet për t'u parë. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit 2017 - 10 përqind e të




KAPACITETI ORGANIZATIV NË SHQIPËRI

anketuarve në Shqipëri deklaruan se kanë marrë pjesë në nisma vullnetare në 2016, krahasuar me 11 përqind në vitin 2015.

Edhe pse përparimi teknik ndryshon midis OShC-ve të mëdha dhe atyre të vogla, në përgjithësi OShC-të i përdorin në mënyrë aktive dhe efektive platformat TIK dhe platformat online për të ndihmuar veprimtarinë e tyre të përditshme. Aksesit broadband vazhdoi të rritej gjatë vitit 2017.

## QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE: 4.5



QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE NË SHQIPËRI

të kuadrit fiskal dhe ligjor.”

Burimet e brendshme të financimit janë përgjithësisht të pamjaftueshme për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Që nga viti 2009, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ka qenë burimi kryesor i financimit shtetëror për OShC-të. Gjatë vitit 2017 AMShC shpalli një thirrje për propozime me dy komponentë: financim për projekte të mbuluara nga AMShC dhe financim për projekte të bashkë-financuara nga donatorët e tjerë dhe AMShC. U dhanë një total prej tridhjetë e pesë grantesh që varionin nga 1.5 milionë lekë (rreth 14.000\$) deri në 4.5 milionë lekë (rreth 41.000\$). Thirrja mbështeste projekte në fusha të ndryshme, duke përfshirë sundimin e ligjit, mbrojtjen e mjedisit, migrimin dhe kulturën. Në dhjetor, Kryeministria shpalli një thirrje të hapur për kandidatë për Bordin Mbikëqyrës të AMShC. OShC-të prej kohësh kanë kërkuar reformimin e AMShC-së në mënyrë që të rritet llogaridhënia dhe transparenca, për shembull duke eliminuar rolin e dyfishtë të Bordit si një autoritet dhe mbikëqyrës dhe vendimmarrës.

Që prej vitit 2014, Ministria e Kulturës financoi projekte të individëve dhe OShC-ve, lokale dhe të huaja, që punojnë në fushën e kulturës. Në vitin 2017, Ministria e Kulturës bashkë-financoi 107 grante. Që prej vitit 2015, Bordi i Çështjeve të Mira i Lotarisë Kombëtare mundëson alokimin e kontributit nga xhiro vjetore e lotarisë, tek OShC-të, individët dhe institucionet publike. Megjithatë, gjatë vitit 2017, u dha vetëm një grant për projektin e një OShC-je me fokus rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi diabetin. Thirrjet për propozime me të ardhurat e lotarisë në përgjithësi nuk i specifikojnë fushat prioritare për financim.

Sektori varet në një shkallë të madhe nga mbështetja e huaj. BE është donatori më i madh i shoqërisë civile në Shqipëri. Donatorë të tjerë të rëndësishëm janë: Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), Ambasada Zvicerane, Ambasada e Mbretërisë së Holandës dhe USAID. Në vijim të qasjes së ri-grantimit të

ndjekur nga donatorët e huaj gjatë viteve të fundit, më shumë fonde janë bërë të disponueshme për OShC-të lokale gjatë vitit 2017 përmes skemave të nën-grantimit të zbatuara nga organizatat lokale ndërmjetëse. Megjithatë, OShC-të jashtë Tiranës priren të kenë kapacitete thithëse të kufizuara. Vlerësimet e para të skemave të ri-grantimit tregojnë se ato janë relevante për mbështetjen e organizatave të vogla, por theksojnë problemin e sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë.

Donacionet private—si nga kompanitë dhe individët—mbeten sporadike dhe të kufizuara në fushatat ad hoc për mbledhjen e fondeve. Mediat sociale i kanë ndihmuar OShC-të për të përdorur teknika më kreative për mbledhjen e fondeve. Për shembull, në vitin 2017, Down Syndrome Albania mbledhi fonde për ofrimin e terapive për sindromën down nëpërmjet mediave sociale dhe angazhimit të personazheve publikë. Donacionet në natyrë—veçanërisht ato që targetojnë grupet e marginalizuara (përfshirë fëmijët dhe të moshuarit) si dhe ndihmat për fatkeqësitë natyrore—vazhdojnë të jenë më të përhapura sesa donacionet financiare. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit 2017, përqindja e shqiptarëve që raportuan se kanë dhuruar për bamirësi u rrit nga 22 për qind në vitin 2015 në 28 për qind në vitin 2016. Sipas raportit të Partners Albania mbi Aktivitetin Filantropik të Ndërmarrjeve (2017), donacionet e biznesit kryesisht targetojnë zbutjen e varfërisë, arsimin dhe shëndetin.


Numri i OShC-ve që ushtrojnë aktivitet ekonomik është ende shumë i kufizuar. Disa OShC fitojnë të ardhura përmes ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, trajnimeve profesionale dhe shërbimeve bujqësore, ndonëse shërbimet e ofruara ofrohen më lirë se çmimet e tregut. Matrica e Monitorimit e Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri për vitin 2016 liston kërkesat administrative dhe kapacitetet e kufizuara të OShC-ve si sfidat kryesore që pengojnë OShC-të të zhvillojnë aktivitet ekonomik.

Vetëm një pjesë e OShC-ve kanë ngritur sisteme të shëndosha të menaxhimit financiar. Projektet individuale u nënshtrohen auditeve të pavarura financiare sipas kërkesave të donatorëve. Standardi Kombëtar i Kontabilitetit i Organizatave Jofitimprurëse, i cili synon të standardizojë kontabilitetin dhe mbajtjen e llogarive për OShC-të, hyri në fuqi në vitin 2016. Nuk ka informacion mbi zbatimin e tij në vitin 2017.

### ADVOKIMI: 3.3

Advokimi i OShC-ve nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2017. Edhe pse OShC-të u angazhuan në një numër në rritje nismash të suksesshme advokimi gjatë vitit, shoqëria civile ende nuk është e përfshirë në mënyrë të qenësishme në dialogun gjithëpërfshirës politik. Sipas Raportit të vitit 2018 të Komisionit Evropian për Shqipërinë “nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të siguruar konsultime kuptimplota me aktorët e shoqërisë civile si pjesë e një dialogu gjithëpërfshirës politik.”

Në dhjetor 2017 u bë konstituimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), i themeluar me ligjin 119/2015. KKShC është një organ këshillimor kolegjal i përbërë nga trembëdhjetë përfaqësues të shoqërisë civile dhe trembëdhjetë përfaqësues të qeverisë që synon të promovojë bashkëpunimin institucional midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)



ADVOKIMI NË SHQIPËRI

kryeson KKShC, ndërsa AMShC vepron si sekretariati teknik. Pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, Këshilli ngeli në limbo, pasi MMSR dhe ministri të tjera u shkriën, duke sjellë paqartësi mbi kryesinë dhe përfaqësuesit qeveritarë të Këshillit. Gjatë mbledhjes së tij të parë zyrtare, Këshilli miratoi rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij. Ndërkohë, mbetet për t'u parë nëse pritshmëritë e larta që kishte shoqëria civile për Këshillin do të përmbushen.

Gjatë vitit 2017, shoqëria civile vazhdoi të rrisë ndërgjegjësimin publik për Ligjin mbi të Drejtën e Informimit dhe Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Ndërkohë që ka pasur më shumë dëgjesa publike dhe konsultime, raporti i vitit 2018 i Komisionit Evropian për Shqipërinë theksoi se ka nevojë për përpjekje të konsiderueshme për të siguruar konsultime të qenësishme me OShC-të. Një raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (2017) konstaton se proceset e konsultimit publik nga pushteti ekzekutiv mbeten në nivele të pakënaqshme dhe shpesh organizohen thjesht për formalitet. Sipas sondazhit të opinionit publik të IDM në nëntor 2017, vetëm 40 përqind e shqiptarëve mendojnë se sugjerimet mbi projektligjet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit merren në konsideratë, nga 54 përqind që ishte në vitin 2016.

Nismat qytetare në 2017 adresuan një numër të madh çështjesh që variuan nga sundimi i ligjit dhe të drejtat e grave në zhvillimin rural dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjatë vitit, këto nisma ngritën dhe mobilizuan me shkallë të ndryshme suksesi bazat e tyre mbështetëse.

Në shkurt, pas një greve urie, rreth dyzet banorë të fshatit Zharrëz ndërmorën një marshim prej 100 kilometrash nga fshati i tyre deri tek Ministria e Energjisë në Tiranë. Marshimi u organizua në shenjë proteste ndaj refuzimit të qeverisë për të riparuar dëmet e përsëritura në shtëpitë e tyre, që dyshohej se ishin shkaktuar nga nxjerrja e naftës në zonë nga Bankers Petroleum. Në mars, qeveria miratoi një vendim për t'u dhënë kompensim monetar për banorët. Deri në maj 2018, ata ishin kompensuar vetëm pjesërisht.

Në dhjetor 2016, tre OShC me profil mjedisor (EcoAlbania, RiverWatch dhe EuroNature) dhe tridhjetë e tetë banorë lokalë dorëzuan një padi në Gjykatën Administrative të Tiranës kundër Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, duke kërkuar anulimin e kontratës koncesionare të hidrocentralit të Poçemit. Në maj, Gjykata Administrative Tiranë vendosi kundër ndërtimit të hidrocentralit duke e konsideruar procedurën e përdorur për të kryer Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si të paligjshme. Kjo ishte çështja e parë mjedisore në gjykatë në Shqipëri.

Në shtator, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural (ANRD), një rrjet prej dhjetë OShC-ve që punojnë për zhvillimin rural, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, organizuan Parlamentin e Parë Rural Shqiptar. Rreth 300 vetë nga qeverisja lokale, organizatat e shoqërisë civile, donatorë dhe akademikë morën pjesë në këtë aktivitet, i cili orientoi prioritetet e zhvillimit rural në axhendën e qeverisë. Parlamenti i Parë Rural Shqiptar miratoi një Deklaratë të Përbashkët mbi sfidat dhe rekomandimet që adresojnë përparësitë e zhvillimit të zonave rurale në Shqipëri.

Gjatë vitit, shoqëria civile vazhdoi të angazhohet në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Në nëntor, OShC-të morën pjesë në takimet konsultative për Raportin Vjetor të vitit 2018 për Shqipërinë. Ndërkohë, për të dytin vit radhazi, Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE), i përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë, duke përfshirë sektorin e shoqërisë civile, nuk arriti të kontribuojë qenësish në procesin e integritit të Shqipërisë, pasi u organizua vetëm një takim. Përveç kësaj, shoqëria civile nuk luajti një rol aktiv në këshill.

OShC-të angazhohen në lobime, pavarësisht faktit se akoma nuk ekziston një kornizë ligjore për të rregulluar një aktivitet të tillë në Shqipëri. Nuk kishte nisma të suksesshme advokimi në nivel vendor gjatë vitit.

Sektori është i vetëdijshëm mbi nevojën e një mjedisi ligjor mundësues për të rritur qëndrueshmërinë e tij. Sidoqoftë, gjatë vitit 2017, vendimmarrësit nuk morrën në konsideratë propozimet e OShC-ve për të miratuar incentiva fiskale për të rritur filantropinë dhe për të unifikuar procedurat e financimit publik.

## OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.6



### OFRIMI I SHËRBIMEVE NË SHQIPËRI

Përfshirë shërbimet bazë sociale siç janë shëndetësia, arsimi, ndihma dhe strehimi, si dhe fusha të tjera, duke përfshirë analizën e politikave dhe ndërtimin e kapaciteteve. OShC-të në përgjithësi i ofrojnë produktet dhe shërbimet e tyre pa diskriminim me bazë gjininë, përkatësinë etnike dhe orientimin seksual. OShC-të zakonisht nuk i shesin produktet e tyre, duke përfshirë këtu botimet dhe workshop-et për akademinë, bizneset apo qeverinë.

Ofrimi i shërbimeve në përgjithësi priret të pasqyrojë nevojat e bazës mbështetëse të OShC-ve, të cilat identifikohen duke kryer vlerësimin e nevojave. Megjithatë, duke qenë se një pjesë e madhe e shërbimeve financohen nga projekte, prioritetet e donatorëve kanë rol në përcaktimin e fokusit të shërbimeve të OShC-ve dhe OShC-të përshtaten lehtë me këto prioritete.

Rikuperimi i kostove mbetet problem. Përfituesit nuk janë në gjendje të paguajnë, kështu që pjesa më e madhe e kostove subvencionohet nga donatorë të huaj ose nga prokurimi publik. Donatorët zakonisht mbulojnë kostot e studimeve, botimeve dhe trajnimeve.

Qeveria e njeh në përgjithësi kontributin e OShC-ve në sigurimin dhe monitorimin e shërbimeve bazë sociale. OShC-ve u lejonet të marrin pjesë në prokurimet publike, megjithëse numri i OShC-ve që konkurrojnë është i kufizuar. Sipas Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile për vitin 2016, vetëm katër nga nëntëdhjetë e gjashtë OShC të anketuara raportuan se kishin përfituar nga kontratat e prokurimit publik. OShC-të argumentojnë se rregullat dhe procedurat e prokurimit publik vendosin pengesa shtesë ndaj OShC-ve, që prej kohësh kanë kërkuar një ligj të ri për prokurimin social. Pas reformës administrative-territoriale të vitit 2014, disa nisma—duke përfshirë Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, Ligjin për Ndërmarrjet Sociale dhe Ligjin e ri për Shërbimet - priret të avancojnë përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve duke ofruar mundësi të reja bashkëpunimii mes qeverisjes vendore dhe OShC-ve. Udhërrëfyesi për Shoqërinë Civile gjithashtu thekson nevojën për të forcuar kapacitetet e bashkive për të bashkëpunuar me OShC-të si aktorë kryesorë në ofrimin e shërbimeve sociale. Megjithatë, këto nisma politike dhe




ligjore ende nuk kanë dhënë rezultatet e synuara. Gjatë vitit 2017, filloi Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore (RELOaD), financuar nga BE dhe zbatuar nga UNDP. RELOaD synon të institucionalizojë ndërveprimin midis OShC-ve dhe bashkive duke financuar rreth 100 projekte të OShC-ve përmes dymbëdhjetë buxheteve të bashkive.

## INFRASTRUKTURA E SEKTORIT: 3.7

Infrastruktura e sektorit u përmirësua gjatë vitit 2017, ndërkohë që më shumë fonde të donatorëve ndërkombëtarë u ri-grantuan, si dhe u intensifikua bashkëpunimi brenda sektorit të OShC-ve.

Nuk ka organizata në Shqipëri që punojnë ekskluzivisht si organizata mbështetëse (ISO). Përkundrazi, shërbimet mbështetëse—që përbëhen kryesisht nga mundësitë e trajnimit—ofrohen kryesisht përmes projekteve të financuara nga donatorë të huaj dhe si rrjedhojë nuk janë të qëndrueshme financiarisht. Gjatë vitit 2017 AMShC vazhdoi të ofrojë asistencë teknike për OShC-të që aplikuan për thirrjet e tyre për propozime dhe u angazhua si sekretariati teknik i KKShC. Asistenca Teknike e BE-së për OShC-të (TACSO) përfundoi programet e saj në Shqipëri në vitin 2017, duke organizuar konferencën e përmblylëse në nëntor.



INFRASTRUKTURA E SEKTORIT NË SHQIPËRI

Që nga viti 2015, donatorët kanë përdorur në rritje qasjen e ri-grantimit në programet e tyre në Shqipëri. Si rezultat, OShC-të ndërmjetësuese zbatojnë skema nën-grantimi për organizatat më të vogla. Për shembull, me financim nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Projekti Lëviz Albania (zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Co-PLAN dhe Partners Albania) mbështesin projekte që synojnë llogaridhënien në nivel vendor. Në vitin 2017, ky projekt dha një total prej tridhjetë e pesë grantesh, disa prej të cilave për individë. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC-Albania) zbatoi programin e financuar nga BE Shoqëria Civile Shqiptare për një Mjedis Evropian - ACHIEVE, 2015-2017. Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC) zbaton projektin e financuar nga BE "Partnerë së bashku kundër korrupsionit" (PACT), i cili alokoi dhjetë grante gjatë vitit 2017 me vlerë të përgjithshme prej 150,000€. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM Albania) zbaton projektin CIVILISC - Instrumente të Shoqërisë Civile kundër Korrupsionit, i financuar nga BE, i cili i dha 19 grante gjatë 2017 me vlerë 250,000€. Këto grante synojnë të fuqizojnë shoqërinë civile për të promovuar mirëqeverisjen dhe për të luftuar korrupsionin. Save the Children dhe Terre des Hommes Albania zbatojnë projektin e financuar nga BE-ja, Shoqëria Civile në Veprim për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, duke ofruar shtatëdhjetë grante në vitin 2017 me një vlerë indikative prej 207,000€. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit në Holandë, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe Together for Life (TFL) ofruan nëntëmbëdhjetë grante me vlerë indikative 187,764€ në kuadrin e projektit të financuar nga BE Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Procesi i ndërtimit të koalicioneve përjetoi një rigjallërim gjatë vitit 2017, pjesërisht për shkak të interesit të donatorëve për krijimin e rrjeteve. Gjatë vitit u krijuan rrjete që mbulonin fusha të ndryshme duke filluar nga zhvillimi rural, sipërmarrja e grave, mbrojtja e mjedisit dhe të drejtat e punonjësve. Për më tepër, ka pasur bashkëpunim në




rritje mes organizatave studimore në kryeqytet dhe organizatave me bazë komuniare. Megjithatë, përkundër rritjes së aktivitetit të rrjeteve dhe koalicioneve, koalicionet prirën të jenë të varura nga donatorët dhe jo të vetëqëndrueshme.

Gjatë vitit, OShC-të vazhduan të kenë akses në një gamë të gjerë të mundësive për trajnim, të cilat zhvillohen kryesisht në Tiranë dhe janë pa kosto pasi mbulojnë nga donatorët. Shumica e trajnimeve ofrohen nga trajnerë lokalë në gjuhën shqipe. Kërkesat për shërbime dhe trajnime të specializuara dhe avancuara, të tilla si planifikimi strategjik, mbledhja e fondeve apo menaxhimi financiar janë të vogla.

Siç u përshkrua më sipër, pas reformave të qeverisjes lokale në vitin 2015, janë krijuar më shumë mundësi për bashkëpunimin e bashkive me OShC-të. Gjithashtu, ka pasur raste të reja të bashkëpunimit ndërsektorial midis OShC-ve dhe bizneseve. Shumica e këtyre iniciativave drejtohen nga OShC-të që kërkojnë të përfshijnë bizneset në projektet e tyre. Për shembull, në muajin shtator, Partners Albania organizoi OJF-Biznes Speed Dating, një takim njëditor me përfaqësues të 15 OShC-ve dhe dhjetë kompanive private për të krijuar kontakte dhe për të identifikuar format e mundshme të bashkëpunimit në të ardhmen. Partneritetet me median ende nuk janë të zakonshme.

### IMAZHI PUBLIK: 3.7



IMAZHI PUBLIK NË SHQIPËRI

Imazhi publik i sektorit nuk pësoi ndryshime të rëndësishme gjatë vitit 2017.

Sipas Liria e Shtypit 2015, mediat shqiptare shfaqin shpesh njëanshmëri të fortë politike dhe interesat e pronarëve të tyre gjatë raportimeve të tyre. Përkundër polarizimit politik të medias, OShC-të përgjithësisht gëzojnë një farë mbulimi mediatik për aktivitetet dhe fushatat e tyre të advokimit, edhe pse raportimi i medias vazhdon të jetë sipërfaqësor dhe i nxitur nga prania e figurave të profilit të lartë në aktivitetet e OShC-ve. Megjithatë, përhapja e mediave online po zgjeron mundësitë e OShC-ve për mbulim mediatik.

Besimi i publikut në shoqërinë civile u rrit gjatë vitit 2017. Sipas sondazhit të opinionit publik të IDM, 57 përqind e të anketuarve në vitin 2017 raportuan se kanë besim tek shoqëria civile, krahasuar me vetëm 46 përqind në vitin 2016. Për më tepër, shoqëria civile u perceptua se kishte një rol në rritje (me 5 pikë përqindje) në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë krahasuar me vitin 2016.

Pavarësisht faktit se e njohin rolin e rëndësishëm të OShC-ve në një shoqëri demokratike, autoritetet shtetërore vazhdojnë të shpërfaqin perceptimet e tyre negative për organizatat advokuese si "të orientuara nga fondet" dhe promovuese të axhendave politike. Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi perceptimin e biznesit për shoqërinë civile.

OShC-të nuk kanë burime të mjaftueshme për të punësuar staf profesional të komunikimit ose për të zhvilluar strategji komunikimi. Ndërsa organizatat e mëdha kanë ngritur disa praktika të komunikimit, OShC-të e vogla dhe lokale nuk kanë aftësi të përshtatshme. Gjithsesi, përdorimi i mediave sociale ka zbutur disa prej këtyre mangësive, duke i mundësuar sektorit të promovojë aktivitetet dhe mesazhet e tij gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017, nuk kishte nisma për vetë-rregullim brenda sektorit. Në përgjithësi, sektori nuk është ende shumë transparent dhe i mungon vetë-rregullimi. OShC-të ende nuk kanë miratuar një kod të etikës të pranuar gjerësisht, megjithëse disa OShC në mënyrë individuale kanë zhvilluar kodet e tyre të etikës dhe sjelljes. Të gjitha OShC-ve u kërkohet të dorëzojnë raporte vjetore tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Vetëm një numër i kufizuar i OShC-ve të konsoliduara publikojnë raporte vjetore në internet.

**Shënim:** Mendimet e shprehura në raport janë të panelistëve dhe hulumtuesve të projektit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose FHI 360.